

PLATFORMË

Kandidate për Këshillin e Lartë të Prokurorisë

Prokurore Elona Alvora

Vizioni

- ▶ Dhënia e kontributit në krijimin e një sistemi prokurorial shqiptar që zhvillon një strategji të qëndrueshme në menaxhimin e burimeve njerëzore (prokurorëve) duke krijuar për secilin prokuror/prokurore mundësi të barabarta zhvillimi profesional dhe përcaktimin e vlerësimit profesional mbi bazën e standarteve të përcaktuara paraprakisht të aftësive e zotësive të formuara nga secili prej tyre me qëllim krijimin e një sistemi meritokratik zhvillimi profesional (d.m.th karrierën e secilit prej tyre që përbëhet në thelb nga këto nivele: menaxhimi I çështjeve, menaxhimi I zyrave prokuroriale dhe ndërtimi I një vizioni për sistemin prokurorial gjatë ndërveprimit me sisteme të tjera).
- ▶ Zhvillimin e mundësive të barabarta për çdo prokuror/prokurore në secilin nivel të karrierës duke sjellë kështu si pasojë krijimin e një sistemi prokurorial të besueshëm, të drejtë, të pavarur, profesional dhe të orientuar drejt shërbimit, transparent në veprimtarinë e tij sipas ligjit, të përgjegjshëm dhe efikas.
- ▶ Krijimin e një sistemi prokurorial që gëzon besimin e publikut dhe që mbështet zhvillimin e qëndrueshëm social-ekonomik të vendit duke mundësuar përmbushjen e objektivave të vendit për integrim në shoqërinë evropiane.

Qëllimi i këtij kandidimi



Vënia e eksperiencës sime profesionale në dispozicion të prokurorëve për t'u bërë pjesë e strategjisë së KLP për të garantuar pavarësinë, përgjegjshmërinë, transparencën dhe efikasitetin e vendimmarrjes së organeve të qeverisjes së sistemit prokurorial.

Të jem pjesë aktive në sigurimin e pavarësinë së prokurorisë (duke përfshirë këtu edhe pavarësinë e brendshme të prokurorëve të çështjeve) që do të garantonte:

- a) një rritje të pavarësisë së gjyqësorit;
- b) statusin, përgjegjshmërinë, llogaridhënien dhe paanësinë e prokurorëve.

Pse duhet të japim kontributin tonë në mirëfunksionimin e KLP?

- ▶ Pavarësisht përmbajtjes që ka pasur legjislacioni I mëparshëm për institucionin e prokurorisë, organet e krijuara si rrjedhojë e këtij legjislacioni kishin krijuar procedura jotransparente në lidhje me vendimet e emërimit, transferimit, promovimit dhe disiplinimit të prokurorëve. Konstatohet mungesa e një procedure standarte vlerësimi që të shoqërohej me kriteret specifike objektive për matjen e aftësive, profesionalizmit dhe integritetit.
- ▶ Me konstituimi e KLP-së në dhjetor të vitit 2018 e në vijim, situata nuk ndryshoi në rritmin e kërkuar në drejtim të rritjes së transparencës dhe të ndërtimit të mekanizmave efikas nëpërmjet rregulloreve të lidhura me karrierën dhe lëvizjen e prokurorëve që kanë vite që kontribuojnë në sistem, në lidhje me përcaktimin e standarteve paraprake për vlerësimin e prokurorëve dhe për të vijuar më tej me standartet për efekt të karrierës, për ndërtimin e mekanizmave për llogaridhënien dhe përgjegjshmërinë. Rëndësi paraqet krijimi dhe konsolidimi i praktikave të lidhura me këto çështje (sidomos të vlerësimit mbi bazë standartesht të deklararura paraprakisht) pasi kjo nevojë do të bëhet emergjente kur nga viti 2022 e në vijim KLP pritet të marrë shtesë detyrash, të cilat po ushtrohen aktualisht nga organe të tjera.

Synimet

Funksionimi me kapacitet të plotë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Krijimin e vizioneve bashkëkohore (zhvendosja nga nocioni i “zyrave të kuadrit” në nocionin e “zhvillimit strategjik të burimeve njerëzore”) dhe ndërmarrja e veprimeve konkrete për ndryshimin e praktikave të mëparshme në menaxhimin e burimeve njerëzore (prokurorëve).

Mirëfunksionimi i strukturës sipas pritshmërive të legjislatorit dhe publikut.

Krijimin për grupet e interesit (prokurorët dhe subjekteve të tjera pjesë e sistemit të prokurorisë në R.SH) i mundësive të barabarta në zhvillimin karrierës dhe trajtim të barabartë (shmangie të kulturalizimit për aq sa është e mundur).

Funksionimi me kapacitet të plotë të Këshillit të Lartë të Prokurorisë

- ▶ Kandidimi im mbështetet në aftësitë personale dhe profesionale, eksperiencën shumëvjeçare të pandërprerë në sistemin e prokurorisë, integritetin personal dhe profesional.
- ▶ Pjesëmarrja ime në këto zgjedhje bazohet në respektimin e të drejtës së votës së secilit prokuror dhe në respektimin e vendimmarrjes së Mbledhjes së Përgjithshme të prokurorëve (të kandidatit që do të dalë fitues dhe që do të plotësojë vakancën e krijuar në KLP si pasojë e shkarkimit të anëtarit të mëparshëm gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar të figurës së tij).
- ▶ Në rast të përzgjedhjes sime si fituese të përmbush me korrektësi e profesionalizëm detyrat e parashikuara nga ligji si pjestar i trupës kolegjiale (duke ngritur problematikat reale të mjedisit aktual ku ushtrojnë funksionin e tyre veçanërisht prokurorët të shkallës së parë) apo detyrave individuale të caktuara nga Këshilli.

Krijimi dhe konsolidimi I praktikave të reja të menaxhimit të burimeve njerëzore (prokurorëve) në KLP.

Në rast se zgjidhem anëtare e KLP-së, kontributi konkret, duke patur parasysh përvojën jetësore dhe profesionale si prokurorë, do të përqëndrohet në:

Miratimin e akteve normative me karakter të përgjithshëm detyruës mbi të gjithë prokurorët (rregullave të përcaktimit të standarteve të vlerësimit profesional të prokurorëve të kërkuara në gjendjen aktuale dhe jo gjendjet ideale që do të duhej të ishte prokuroria). Në këtë kuadër kalimi nga sistemi ku prokurorët krahasohen me njëri-tjetrin në sistemin ku zhvillimi profesional i çdo prokurori krahasohet me standartet e përcaktuara paraprakisht besoj se do të krijojë një klimë tjetër edhe për subjektet e reja që shikojnë në të ardhmen mundësinë e hyrjes në sistemin prokurorial;

Miratimin dhe ndryshimin e akteve për rregullimin e procedurave të brendshme të KLP me fokus të veçantë rritjen e transparencës në nivel komisioni (mungesa e transparencës në nivel komisioni është kritikuar në raportet e shoqërisë civile);

Miratimin apo ndryshimin e rregullave për funksionimin e administratës së Këshillit (me qëllim rritjen e efikasitetit të shërbimit dhe krijim e mundësive të barabarta të zhvillimit profesional në administratën e KLP-së);

Miratimin e rregullave të detajuara mbi menaxhimin dhe përdorimin e teknologjisë së informacionit nga institucionet e sistemit të prokurorisë në bashkëpunim me qendrën e teknologjisë së informacionit për sistemin e drejtësisë (e lidhur kjo edhe me situatën e krijuar nga COVID 19 dhe nxitjen e praktikave që marrin në konsideratë përdorimin e teknologjisë).

Hartimin, miratimin dhe zbatimin e planit strategjik për sistemin e prokurorisë me vizionin dhe misionin e KLP, si dhe në koordinim me strategjinë e sektorit të drejtësisë.

Bashkëpunim me Kryetarin e KLP për mirëfunksionimin e strukturës së administratës së Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Përmbushjen e detyrave të parashikuara nga ligji si pjestar i trupës kolegjiale apo detyrave individuale të caktuara nga Këshilli.

▶ **Faleminderit p r v emendjen!**

▶ Elona Alvora